VENDIM
Nr.73, datë 17.11.2005

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR SHOQËRINË "FAVINA" SHPK PËR VITIN 2005

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve "Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël", Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2005, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Favina" sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-in Vithkuq të rrethit të Korçës,

VENDOSI:

1. Mosmiratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria "Favina" sh.p.k., për H/C-in Vithkuq të rrethit të Korçës, me arsyetimin e mosdërgimit të të dhënave të sakta në aplikimin e paraqitur në ERE nga kjo shoqëri, si dhe mosndarja e llogarive për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema